

**Dr. Çelo Hoxha (1969), historian, gazetar, përkthyes.**

Mban postin e Drejtorit Ekzekutiv të ISKK prej 23 dhjetor 2019. Para kësaj detyre ka qenë Zv/Drejtor Ekzekutiv të ISKK, 2011-2019. Para se t'i kushtohej punës shkencore në fushën e historisë, ai ka punuar për shumë vite gazetar; për një periudhë ka qenë Drejtor i Lajmeve në ATSH. Diplomën universitare e ka për mësuesi (cikli i ulët, 1994), Gjirokastrë. Vite më vonë është diplomuar për master shkencor në histori (2011) dhe doktor i shkencave historike (2018) pranë Institutit të Historisë, Akademia e Studimeve Albanologjike, Tiranë. Masterin shkencor dhe doktoraturën i mbrojti me punime me temë nga periudha e regjimit komunist në Shqipëri. Ai është autor i disa studimeve, i shumë artikujve shkencorë, të gjithë me temë nga historia e regjimit komunist, dhe një nga drejtuesit dhe autorët e projektit me 10 vëllime, "Enciklopedia e viktimit të terrorit komunist", botuar nga ISKK. Libri i tij "Krimet e komunistëve gjatë luftës, 1941-45" (2014) ka qenë një nga librat dokumentarë dhe studimorë më të debatuar publikisht në periudhën post komuniste.

Disa botime në fushën e historisë:

"Fillimet e komunizmit në Shqipëri", ISKK, 2013.

"Krimet e Komunistëve gjatë luftës, 1941-1945", ISKK, 2014.

"Politikat e regjimit komunist në Shqipëri, 1960-1980", ISKK, 2022.

## **Dr. Armanda Hysa**

Dr Armanda Hysa është etnologe dhe historiane, Zv/Drejtoreshë e Institutit të Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit në Tiranë që prej vitit 2020. Për 17 vite ka qenë etnologe pranë Departamentit të Etnologjisë, Fillimisht si pjesë e Institutit të Kulturës Popullore të Akademisë së Shkencave, e më pas si pjesë e Institutit të Antropologjisë Kulturore dhe Studimeve të Artit, Qendra e Studimeve Albanologjike. Në vitet 2012 – 14 Dr. Hysa ishte Alexander Nash Fellow in Albanian Studies, pranë School of Slavonic and East European Studies, University College London. Interesat e saj kërkimore lidhen me çështje të identiteti dhe nacionalizmit në Ballkan, çështje të trashëgimisë osmane, si dhe së fundmi, çështje që lidhen me analizën e strukturave dhe krimeve të diktaturës komuniste në Shqipëri. Njëkohësisht Dr. Hysa është edhe pedagoge me kohë të pjesëshme pranë Universitetit të Tiranës.

## **Zoica Graçi**

Mban pozicionin e Drejtorit të Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse. Ka një eksperiencë të gjatë pranë Institutit të Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit, ku punon prej vitit 2011. Ka mbajtur pozicionin e Përgjegjesit të Sektorit të Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse nga 2011 -2021. Është diplomuar si kontabiliste në vitin 2001, dhe ka master shkencor pranë Fakultetit të Ekonomisë, të Universitetit “E’qrem Çabej” Gjirokastrë. Eksperienca të mëparshme të punës kanë qenë si pjesë e sektorit financiar në institucione shtetërore dhe sektorin privat në pozicione drejtuese si: Drejtoria e Rajonale e Bujqësisë dhe Ushqimit Gjirokastrë, Raiffeisen Bank, Universiteti “E’qrem Çabej” Gjirokastrë etj. Gjithashtu, ka eksperiencë në fushën e menaxhimit të burimeve njerëzore gjatë angazhimit të saj profesional pranë ISKK, si specialiste dhe përgjegjëse. Ka marrë trajnime të ndryshme, si trajnimet e vazhdueshme për Kontabilist i Miratuar, trajnime për Aftesite Menaxheriale dhe trajnimet për Auditimin Ekonomiko – Financiar ku edhe është pajisur me certifikimin përkatës.